



VENDIM

Nr.38 Datë 18.05.2009

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË KODIN E
FUNKSIONIMIT TË RRJETIT (KODI I TRANSMETIMIT)**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, nenit 26 pika 2 te Rregullave te Praktikës dhe Procedutave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.05.2009, pasi shqyrtoi dhe analizoi propozimin e Komisionit të Rishikimit të Kodit të Funkcionimit të Rrjetit (Kodi i Transmetimit), për disa ndryshime në Kodin e Funkcionimit të Rrjetit (Kodi i Transmetimit), të cilat do të mundësojnë përdorimin e njëjësive gjeneruese të pa rregullueshme në disa HEC-e të reja,

Vendosi :

1. Miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave në Kodin e Funkcionimit të Rrjetit (Kodi i Transmetimit), i miratuar me Vendimin nr.123 datë 24.10.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s. (Ndryshimet bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimi të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari I ERE-s

Bujar Nepravishta